

PROF.DR.HFZ  
**HAJREDIN HOXHA**



**EDUKATA E  
MËSUESIT DHE  
STUDIUESIT  
TË KUR'ANIT**



Prof.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**EDUKATA E MËSUESIT DHE STUDIUESIT TË KUR'ANIT**

Vështrim edukativo-islam mbi librin e Imam Neveviut

*“Et-Tibjan fi Adabi Hameleti'l Kur'an”*

Përktheu:

Sedat ISLAMI



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.  
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.  
Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmimin e kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake me shkrim të autorit.

**PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:  
Sedat ISLAMI**

**Recensent: Ajni Sinani  
Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani**

**Titulli në origjinal:**

Dr. Hajruddin Huxheh,

*Adab mual-limi-l-Kur'an ve muteal-limihi*, ed. 1, 1430 h., Medine  
Munevvere: Matbaatu-rr-Rreshid.

Dr. Hajredin HOXHA

**EDUKATA E MËSUESIT DHE STUDIUESIT TË  
KUR'ANIT**

Vështrim edukativo-islam mbi librin e Imam Neveviut

*"Et-Tibjan fi Adabi Hamleti'l Kur'an"*

## **Hyrje**

Falënderimet i takojnë Allahut, i Cili në Librin e Tij fisnik thotë:

*“Ata që lexojnë librin e All-llahut, e falin namazin dhe nga begatitë që Ne u kemi dhënë japin fshehtazi e haptazi, ata shpresojnë në një fitim që kurrë nuk humbet.”* Fatir, 29.

Përshëndetjet qofshin mbi Muhammedin [*alejhi's selam*], i cili ka thënë:

*Më i miri prej jush është ai që mëson Kur'anin (për vete) dhe ua mëson atë të tjerëve!”* (Transmeton Buhariu.)

Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi familjen, shokët dhe të gjithë ata që pasojnë rrugën e tij gjer në amshim!

Dijetarët tanë nga Selefus-Salihi (gjeneratat e hershme muslimane) i kanë kushtuar rëndësi të veçantë Kur'anit, në kuptimin e nxënies përmendsh, mësimit dhe komentimit, sikurse që nuk e kanë anashkuar etikën dhe moralin me të cilat duhet të shquhen studiuesit dhe bartësit e Kur'anit (hafëzët). P.sh. dijetari i madh Ebu Bekir Ibn el-Hasen el-Axhurrij (vd.360 h.) ka shkruar një libër me titull “*Ahlaku hamleti-l-Kur'an*” (Moralit i bartësve të Kur'anit), pastaj kolosi Ebu Zekerijja Jahja Ibn Sheref en-Nevevi (vd. 676 h.) ka shkruar librin “*et-Tibjanu fi adabi hamleti-l-Kur'ani*”, i cili edhe është objekt studimi në këtë punim.

Në fakt, ata që kanë shkruar në këtë fushë janë të shumtë dhe natyra e punimit nuk na lejon që t'i përmendim të gjithë, kështu që ne do të fokusohemi vetëm në librin e lartpërmendur.

Ky libër ka lënë gjurmë të pashlyera në shpirtin tim dhe më duhet ta pranoj se ai ka ndikuar shumë në formimin e ideve dhe personalitetit tim.

Qëndrimi dhe studimi i gjatë i Kur'anit kishte ndikuar shumë në formimin e Imam Neveviut në fushën e edukimit dhe mësimdhënies. Këtë mund ta kuptojë çdokush që shfleton seriozisht librin e tij. Ndërsa për ndikimin e Kur'anit tek lexuesi, gjegjësisht tek idetë dhe shpirti i tij, Sejjid Kutbi thotë: “*Ky libër ishte burim i vetëm për njohuritë, edukimin, udhëzimin dhe formimin e një gjenerate të rrallë... një gjenerate të papërsëritur në historinë e njerëzimit, as më herët dhe as më vonë, gjeneratës së*

*sahabëve të ndershëm, të cilët shkaktuan në historinë njerëzore atë ngjarje të madhe, të thellë dhe të shtrirë, që fatkeqësisht nuk është studiuar me seriozitet deri më sot...”*

Vërtet, mirësia e Allahut ndaj nesh ishte e madhe, ngaqë na zgjodhi që të jemi bartës të fesë së Tij tek njerëzit dhe edukues të gjeneratave në këto vende të bekuara, në Medinën e Muhammedit [alejhi's selam], kështu që e pamë si detyrim që të zbardhim disa të vërteta dhe mësimë edukative nga përvoja e këtij Imami të madh, respektivisht nga libri i tij i sipërpërmendur.

Etika dhe komponentët edukativë të përmendur në këtë libër, edhe pse janë thënë në fakt vetëm për mësuesit dhe studiuesit e Kur'anit, mund të përdoren fare mirë, në kuptim të përgjithshëm, për të gjitha shkencat dhe profilet, si dhe për të gjithë mësuesit dhe studiuesit. “*Mësimi merret nga forma e përgjithshme e tekstit e jo nga ekskluziviteti i shkaktuar*” – thotë rregulli.

Shumë mësues, edhe nëse bartin tituj dhe grada të larta akademike, janë shumë larg vlerave, normave dhe parimeve njerëzore, edukative dhe fetare, për të cilat ka aluduar Imam Neveviu në librin e sipërpërmendur. Si rezultat, mund të hasësh në mësues të mërrolur, të vrazhdë, të dhunshëm, të ashpër, ofendues, ziliqarë ndaj studentëve etj. Besoj se ankesat drejtuar organeve përgjegjëse për mësues dhe profesorë të tillë nuk janë diç të huaja për ne.

Konsideroj se libri që kemi përpara do të jete një fanar ndriçues për ata që duan të marrin mësim dhe të jenë falënderues.

Le të ndajmë disa çaste me faqet e këtij libri madhështor.

Imam Neveviu ka thënë:

**Etika e mësuesit të Kur'anit...**

Gjëja e parë që duhet ta synojë mësuesi dhe lexuesi i Kur'anit është kënaqësia e Allahut. Fudajl Ibn Ijjadi ka thënë: *'Braktisja e një pune për shkak të njerëzve është dyfaqësi, puna për hir të njerëzve është shirk, kurse sinqeriteti është që Allahu të të shpëtojë prej këtyre dy gjendjeve (të para).'*

Ndërsa Pejgamberi [*alejhi's selam*] ka thënë:

*Kush e mëson një shkencë me të cilën (do të duhej të) kërkohet kënaqësia e Allahut, ndërsa ai e mëson për ndonjë interes material të kësaj bote, ai nuk do ta ndiejë erën e xhenetit në Ditën e Kiametit...'*[Transmeton Ebu Davudi, ndërsa Albani e cilëson autentik (shën. i përkth.)]

Më pas Imam Neveviu flet për sinqeritetin e mësuesit në raport me studentin, duke nënvizuar disa gabime në të cilat bien shumë mësues, profesorë dhe hoxhallarë (shujh). Ne do të shkëpusim disa fragmente nga fjalët e tij:

**Sinqeriteti i mësuesit ndaj studentit:** Mësuesi duhet të ketë kujdes që qëllimi i tij të mos jetë grumbullimi i një numri sa më të madh studentësh afër vetes, sikurse që duhet të jetë i kujdesshëm që të mos ketë zili nëse ata që mësojnë tek ai frekuentojnë edhe dijetarë të tjerë prej të cilëve ata përfitojnë. Fatkeqësisht, disa mësues injorantë sprovohen me këtë gjë, gjë që dëshmon për qëllimin e keq të tyre, apo më drejt, kjo është dëshmi se ata nuk kanë synuar kënaqësinë e Allahut me punën e tyre, përndryshe ata nuk do ta ndienin këtë urrejtje. Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: *"O bartës të Kur'anit (ose ka thënë: o bartës të diturisë), punoni sipas dijes suaj, ngase dituri është veprimi sipas saj dhe përputhja e veprës me dituri. (Në të ardhmen) Do të ketë njerëz dituria e të cilëve nuk do ta tejkalojë fytyrën e tyre; dituria e tyre do*



*të nuk përputhet me veprat e tyre, fshehtësitë e tyre do të jenë në shpërputhje me veprat e tyre publike. Ata do të qëndrojnë në grupe dhe do t'i i mburren njëri-tjetrit, saqë ndonjërit prej tyre nuk do t'i pëlqejë që shoku i tij të ulet tek tjetri... ata janë njerëz veprat e të cilëve nuk ngrihen nga ato mexhlise deri tek Allahu...”*

Preferohet që mësuesi t'i favorizojë nxënësit dhe mësimin e tyre ndaj interesave të tij, të cilat nuk i ka të domosdoshme. Në kohën kur i mëson ata, duhet të jetë i distancuar nga çdo gjë që ia zhvendos vëmendjen nga mësimi. Ai duhet t'ua ofrojë njohuritë nxënësve në përputhje me kapacitetin e tyre; ata që nuk kuptojnë shumë, nuk duhet t'i ngarkojë shumë dhe, anasjelltas, ata që kanë kapacitete të mëdha për të mësuar nuk bën t'i lërë me pak. Kohë pas kohe, ai duhet të bëjë përsëritje nëse nxënësit i mbajnë mend apo jo ato që i kanë mësuar më herët.

Ai mund të bëjë përjashtime, nëse ia merr mendja për ndonjërin se nuk ka nevojë. Ndërsa ata që nuk tregohen shumë të suksesshëm duhet t'i qortojë, por jo ashpër ngase kjo mund të shkaktojë largimin dhe neveritjen e tyre nga mësimi. Mësuesi nuk duhet t'i xhelozojë nxënësit nëse ndonjëri shfaq zgjuarsin, ngase nëse një gjë e tillë ndalohet në raport me të huajt atëherë si mund të mos ndalohet në raport me mësuesin dhe nxënësin e tij, për të cilin në fakt ai është si prind i dytë?! Pastaj, ai nuk do të privohet nga shpërblimi i tij në ahiret, për shkak se ky ka qenë shkaktar i mësimin dhe edukimit të tij.

Mësuesi duhet të dalë para tyre i buzëqeshur, të interesohet për ta dhe të pyesë kur ata mungojnë.

## EDUKATA E MËSUESIT TË KUR'ANIT

Për moralin, edukatën, tiparet dhe virtytet me të cilat duhet të shquhet mësuesi, Imam Neveviu thotë:

**Morali i përsosur:** Mësuesi duhet të jetë i pajisur me tipare, cilësi dhe veti të pëlqyera, për të cilat na ka udhëzuar Allahu, si: asketizmi në dynja, bujaria, fisnikëria, buzëqeshja - por pa i tejkaluar kufijtë e normales, butësia, durimi, ikja nga përfitimet e paligjshme, të qenit i devotshëm, modest, i matur, i urtë; shmangia nga të qeshurit e tepërt, nga shakaja e pakripë; mbajtja e pastërtisë fetare: pastrimi i trupit, prerja e thonjve, shkurtimi i mustaqeve, krehja e mjekrës, largimi i erërave të pakëndshme nga trupi etj...

Po kështu, ai duhet të jetë shumë i kujdesshëm që të mos vuajë nga zilia, smira, dyfaqësia, vetëpëlqimi, nënçmimi i tjerëve... Ai duhet ta ketë vetëdijen fetare në nivelin e duhur (el-murakabe), pavarësisht se është vetëm apo në shoqëri, si dhe duhet t'i mbështetet Allahut për çdo gjë.

Ai duhet t'i trajtojë me butësi nxënësit e tij, t'iu urojë mirëseardhjen dhe të jetë bamirës ndaj tyre. Pejgamberi [*alejhi's selam*] ka thënë:

*Vërtet, njerëzit do t'iu pasojnë. Do të vinë tek ju burra nga të gjitha anët e botës për të mësuar fenë, andaj silluni mirë me ta kur t'iu vijnë.*" [Transmeton Tirmidhiu, ndërsa Albani e ka klasifikuar si të dobët (shën. i përkth.)]

Mësuesi duhet t'i këshillojë studentët dhe nuk duhet ta kursejë ndihmën e tij për t'iu përgjigjur pyetjeve që i preokupojnë ata. Ai duhet të jetë vigjilent për t'ua përfituar zemrat atyre dhe për t'i nxitur ata për mësim. Ai duhet t'i nxisë ata duke u përkujtuar atyre

vlerën e mësimit, vlerën e përkushtimit ndaj Kur'anit dhe shkencave të tjera fetare, si dhe duke ua përkujtuar se një rrugë e tillë është trasuar nga robërit e singertë të Allahut, pejgamberët dhe të dërguarit e Allahut [*alejhimus selam*].

Mësuesi duhet të kujdeset për nxënësin ashtu siç kujdeset për birin e vet apo edhe për veten e tij. Ai duhet të ketë durim ndonjëherë për mungesën e edukatës nga ana e nxënësit, ngase nuk ka njeri pa të meta. Ai duhet të dojë për nxënësin atë që do për vete, sikurse që duhet ta urrejë për të atë që urren për veten e tij. Nuk është mirë që mësuesi të tregohet mendjemadh ndaj nxënësve, përkundrazi, ai duhet të jetë i butë dhe modest me ta. Nëse për modestinë janë thënë fjalë aq të mira, madje edhe kur ajo shfaqet në raport me njerëzit e rëndomtë, atëherë ç' mund të thuhet për të kur ajo shfaqet në raport me këta njerëz të veçantë, me studentët, me ata që janë përcaktuar për t'i shërbyer Kur'anit?! Pejgamberi [*alejhis selam*] ka thënë: “*Bëhuni të butë ndaj atyre që i mësoni dhe ndaj atyre prej të cilëve mësoni...!*” [Albani me tekst të përafërm, e vlerëson hadithin si të dobët (shën. i përkth.)]

Më pas, Imam Neveviu, i qaset një çështjeje tjetër të rëndësishme që ka të bëjë me arsimin, e që është: gradualiteti në mësim dhe mbamendje (nxënie përmendsh), duke thënë:

**Familjarizimi me studentin.** Studenti duhet edukuar në mënyrë graduale në mënyrë që ai të përvetësojë tipare të pëlqyera të moralit. Mësuesi duhet ta dresojë atë edhe për çështjet e fshehta, ta kontrollojë edhe për gjërat e imëta, ta nxisë me fjalë dhe vepra për sinqeritet, korrektësi, qëllime të mira, ndjenjën e të qenit përherë nën vëzhgimin e Allahut, pasi vetëm kështu atij mund t'i hapen dyert e dijes, mund t'i zgjerohet gjoksi, mund t'i shpërthejnë nga zemra urtësitë dhe të ketë bereqet në fjalët dhe veprat e tij...

Gjërave që mësuesi duhet t’iu kushtojë kujdes gjatë mësimit janë:

- Të mos luajë me duart e tij
- Të mos shikojë vërdallë nevojë e pa nevojë,
- Të jetë me abdes dhe i kthyer në drejtim të kibles,
- Të ulet me qëndrim prej muslimani,
- T’i ketë rrobat e bardha dhe të pastra
- Të ulet këmbëkryq apo si të dojë, ngase Abdullah Ibni Mes’udi ligjëronte duke qenë në gjunjë.

Hapësira duhet të jetë e mjaftueshme që t’i zërë të gjithë, ngase në një hadith të Muhammedit [*alejhis selam*] thuhet: “*Mexhliet më të mira janë ato më të gjerat...*”

Mësuesi duhet t’ua tërheqë ashpër vërejtjen nxënësve që të mos e marrin Kur’anin për qëllime përfitimi të kësaj bote. Pejgamberi [*alejhis selam*] ka thënë:

*Lexojeni Kur’anin dhe mos hani prej tij...*” [Hadithin e transmetojnë Imam Ahmedi dhe të tjerë, ndërsa Albani konsideron se hadithi është autentik (shën. i përkth.)]

Në fakt është një çështje e diskutueshme tek dijetarët nëse lejohet apo jo pagesa për mësimin e Kur’anit. Një grup, përfshirë Ebu Sulejman Hitabiun, Zuhriun dhe Ebu Hanifen, e kanë ndaluar një gjë të tillë, ndërsa të tjerë, si Hasan Basriu, Ibni Sirini, kanë thënë se lejohet, por me kusht që pagesa të mos kushtëzohet qysh më parë. Por ka edhe të tillë, si Atau, Maliku, Shafiu dhe të tjerë që e lejojnë edhe kushtëzimin, por që kërkojnë që puna të kryhet mirë.

## EDUKATA E NXËNËSIT TË KUR'ANIT

Imam Neveviu [*Allahu e pastë mëshiruar*] flet edhe për moralin dhe edukatën e nxënësit, si dhe për tiparet që duhet ta karakterizojnë personalitetin e tij.

**Sa i përket moralit dhe edukatës së nxënësit**, tërë ajo që kemi përmendur më parë për mësuesin, vlen edhe për nxënësin. Krahas tyre, nxënësi duhet të shmanget nga çdo gjë që e largon nga mësimi. Ai duhet ta pastrojë zemrën, në mënyrë që të jetë i aftë për ta pranuar Kur'anin, për ta mbajtur mend atë dhe për të shkoqitur domethëniet dhe mësimet e tij. Është vërtetuar se Pejgamberi [*alejhis selam*] ka thënë:

*...Vini re, në trup është një copë mishi, e cila nëse është e shëndoshë, është i shëndoshë tërë trupi, e nëse prishet (sëmuret), prishet i tërë trupi. Ajo (copë mishi) është zemra.”* (Hadithin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.)

Sa bukur ka thënë një njeri: *‘Zemra përgatitet për dituri ashtu sikurse që toka përgatitet për mbjellje.’*

Nxënësi duhet të jetë modest me mësuesin e tij. Ai duhet të tregohet i kulturuar ndaj tij, edhe nëse rastis që mësuesi i tij të jetë më i ri se ai apo edhe të mos ketë famë a familje mbi ato të tij. Nxënësi duhet të kuptojë njëherë e përgjithmonë se diturinë do ta përvetësojë vetëm atëherë kur të jetë modest në raport me të. Ai duhet t'i nënshtrohet mësuesit, të konsultohet me të për të gjitha

çështjet dhe ta pranojë mendimin e tij mu ashtu si i sëmuri që e pranon mendimin e mjekut.

Nxënësi, paraprakisht, nuk duhet të zgjedhë mësues të papjekur apo ata që nuk janë të njohur edhe për devotshmërinë dhe moralin e tyre të lartë. Selefite kanë thënë: *‘Vërtet, kjo dituri është fe, andaj shikoni se prej kujt po e merrni fenë tuaj!’*

Kësisoj, studenti duhet ta shikojë mësuesin me respekt, duhet të besojë se ai është i denjë për pozitën që ka, se është më i miri ndër bashkëkohësit e tij dhe se ai është njeriu i duhur prej të cilit duhet të përfitojë dije. Nga të parët ka pasur të atillë që, kur shkonin për të marrë dije, jepnin lëmoshë dhe thoshin: *“O Zoti im, mbuloja të metat mësuesit tim, ndërsa mua mos më privo nga bereqeti i dijës së tij!”*

Rebiu, kohaniku i Imam Neveviut, thoshte se, nga respekti i madh që kishte për Imam Shafiun, nuk mund të merrte dot guximin as për të pirë ujë kur ai e shikonte.

Më pas Imam Neveviu citon Aliun [*Allahu qoftë i kënaqur me të*], i cili ka thënë: *“E drejtë e mësuesit është që, kur t’i përshëndesësh njerëzit, ta veçosh atë me përshëndetje, të ulesh përballë tij, të mos ia bësh me gisht, të mos ia bësh me sy dhe të mos i thuash: ‘Filani thotë ndryshe!’ Mos e përgojo askënd, mos u konsulto me bashkëulësin tënd, mos e kap për rroba kur të ngrihet, nëse e di se po përton atëherë mos iu impono, mos insisto ta pyesësh, mos u ngop së qëndruari me të...”*

Studenti – vazhdon Imam Neveviu – duhet të përvetësojë këtë moral si dhe nuk duhet të lejojë përgojimin e mësuesit të tij në ndonjë mexhlis, përndryshe duhet të largohet prej aty.

Nxënësi apo studenti duhet t'i përfillë të gjitha ato që përmendëm më parë kur folëm për mësuesin: duhet të jetë i pastër, duhet t'i pastrojë dhëmbët, të mos merret me çështje të padobishme, të mos hyjë tek mësuesi pa leje në vendet ku kërkohet leje për të hyrë, ta veçojë mësuesin me përhëndetje, të mos hyjë në mexhllis duke shkelur mbi të tjerët, përveç nëse e thërret mësuesi të ulet përpara apo e di se të tjerët i japin leje për një gjë të tillë. Po kështu, nuk bën ta çojë nga vendi askënd, përveç nëse e thërrasin apo nëse dalja e tij përpara ka dobi për të tjerët, duke vepruar kështu sikurse ka vepruar Ibni Omeri [*Allahu qoftë i kënaqur me të*]. Nuk bën mirë të ulet midis dy shokëve, përveç nëse ata e lejojnë. Ai duhet ta ruajë imazhin e mexhllisit të mësuesit dhe duhet të qëndrojë para mësuesit të tij ashtu siç i ka hije një nxënësi. Nuk duhet as ta ngrejë zërin, as të qeshë dhe as të flasë shumë pa nevojë, sikurse që nuk i pëlqehet aspak të luajë me gishtërinj, të kthejë kokën majtas e djathtas, përkundrazi, duhet të kthehet nga mësuesi dhe ta dëgjojë me vëmendje ligjërimin e tij.

Nxënësi nuk duhet të lexojë para mësuesit kur ai ndihet i lodhur, por duhet të shfrytëzojë kohën kur mësuesi është i disponuar, sikurse që duhet të durojë ndonjë sjellje eventuale jo të mirë nga ana e mësuesit. Madje, atyre fjalëve a veprave që sipërfaqësisht mund të komentohen keq, duhet t'iu japë ngjyrë pozitive. Edhe nëse mësuesi gabon, nxënësi duhet t'ia hedhë fajin vetes, duhet të kërkojë falje vetë ai dhe të sillet sikur faji është i tij dhe jo i mësuesit, ngase kështu është më mirë për të, në dynja dhe ahiret. Të parët kanë thënë: '*Kush nuk e duron nënçmimin e mësimit, do të mbetet tërë jetën në errësirën e injorancës, ndërsa kush e duron atë, ia dorëzon vetveten krenarisë së kësaj bote dhe botës tjetër!*' Ibni Abbasi [*Allahu e mëshiroftë*] ka një thënie të njohur në lidhje me këtë aspekt: '*Jam nënshtruar si kërkues, ndërsa jam bërë*

*krenar si i kërkuar!* E sa mirë është thënë: *‘Kush nuk shijon nënçmimin e një çasti, do të mbetet i nënçmuar përherë!’*

Nxënësi duhet të jetë i zellshëm për shfrytëzimin e kohës dhe për vijimin sistematik të mësimave. Ai nuk bën të mjaftohet me pak kur ka mundësi për më shumë, por as nuk duhet ta ngarkojë veten me çka nuk mundet dhe as me gjëra që mund t’i shkaktojnë monotoni. Kjo, në fakt, dallon nga nxënësi në nxënës.

Nëse shkon në mexhlis dhe nuk e gjen mësuesin, atëherë nxënësi duhet të presë tek dera derisa të vijë, ndërsa nëse e gjen, por mësuesi është fjetur apo është i zënë me ndonjë punë, atëherë nuk bën që t’i kërkojë leje për të hyrë, por duhet të presë derisa mësuesi të zgjohet apo ta kryejë punën. Ai edhe mund të mos presë fare, por më e udhës është që të durojë dhe të presë, ashtu siç kanë bërë sahabë të shumtë, si Ibni Abbasi [*Allahu qoftë i kënaqur me të*] dhe të tjerë.

Nxënësi duhet të japë maksimumin e vet dhe ta shfrytëzojë maksimalisht kohën kur e ndien veten më të disponuar, para se të zihet me punë apo të ngrihet në pozitë. Prijësi i besimtarëve, Omer Ibn Hattabi [*Allahu qoftë i kënaqur me të*] ka thënë: *‘Mësoni (bëhuni profesionistë) para se të bëheni udhëheqës!’* Të njëjtën gjë e ka thënë edhe Imam Shafiu [*Allahu e mëshiroftë*]: *‘Mëso para se të bëhesh prijës, ngase atëherë nuk do të kesh mundësi!’*

Nxënësi nuk bën mirë që radhën e tij për të mësuar tek mësuesi t’ia lërë ndokujt, ngase favorizimi në adhurime, ndryshe nga çështjet e rëndomta të kësaj jete, nuk pëlqehet. Por, nëse mësuesi sheh dobi që radha e tij për mësim t’i kalojë dikujt tjetër për një kohë, atëherë ai duhet ta respektojë vendimin mësuesit.



Nxënësi nuk duhet t'i urrejë shokët, nëse ndonjërit prej tyre Allahu i ka dhënë ndonjë mirësi, sikurse që nuk duhet të mashtrohet apo t'i rritet mendja për gjërat me të cilat Allahu e ka dalluar atë nga të tjerët. Për ta bërë këtë, është mirë që të thotë se njohuritë e fituara janë dhuratë prej Allahut, ndërsa zilinë do ta luftonte duke u bindur se ka qenë urtësia e Allahut ajo që ka caktuar që një tipar të jetë tek njëri dhe jo tek tjetri.

Nxënësi duhet të jetë në gjendjen më të mirë, në shkallët më të larta të moralit, duke iu shmangur çdo gjëje që ndalon Kur'anit. Ai duhet të jetë krenar ndaj mendjemëdhënjeve dhe modest ndaj të sinqertëve. Duhet të jetë i sinqertë dhe të ketë qëndrimin e një njeriu të respektuar. Abdullah Ibni Mes'udi [*Allahu qoftë i kënaqur me të*] ka thënë: *'Bartësi i Kur'anit duhet të dallohet gjatë natës kur njerëzit flenë, gjatë ditës kur ata hanë, duhet të dallohet me pikëllimin e tij kur njerëzit gëzohen, me të qarit e tij kur ata qeshin, me heshtjen e tij kur ata zhyten në biseda (të kota), me përuljen e tij kur njerëzit bëhen mendjemëdhënje...*

Fudajl Ibni Ijjadi ka thënë: *'Bartësi i Kur'anit nuk duhet të ketë nevojë për udhëheqës, e lërë më për ata që nuk janë në pozita të tilla!'* Po kështu, ai ka thënë: *'Bartësi i Kur'anit (hafëzi) është bajraktar i Islamit, andaj nuk bën të luajë me ata që luajnë (dëfrehen së koti), të jetë i shkujdesur siç bëjnë të shkujdesurit, dhe as të flasë mbarë e mbrapsht, krejt këtë si respekt ndaj Kur'anit...'*

Allahu qoftë i kënaqur me Imam Neveviun dhe e shpërbleftë me çdo të mirë!

Lutja jonë e fundit është: Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

5.9.2007

Medine Munevvere